




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 09.02.2017, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Agim Gashi, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Mirlinda Sopi, shefe e GP të AKR-së.

Munguan: Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

I pranishëm ishin edhe Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues. Ai tha se ekzekutivi nuk po na përgjigjet, por edhe kryetari po na injoron, d.m.th. nuk tregojnë bashkëpunim dhe duan ta shpallin Kuvendin jo funksional.

Meqë forumi ekzistonte, ai propozoi që të procedohej rendi i ditës, të cilin do ta përcjellin për Kuvend dhe bashkërisht me kryetarin ta caktojnë seancën.

Ai bëri të ditur se ekzekutivi nuk ka sjellë pika për t'u shqyrtuar në Komitet dhe në ndërkohë mund të sjellë material për Kuvend, por ato pika nuk do të futen në rend dite, sepse nuk kanë kaluar nëpër Komitet. Pra, me këtë rend dite që e kemi pasur në komitet do të shkojmë në Kuvend.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor buxhetor për vitin 2016;**
- 4. Caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL “Hortikultura” SHA dhe NPK “Trafiku Urban” SHA Prishtinë;**
- 5. Propozimvendimi për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017;**
- 6. Të ndryshme.**

Mirlinda Sopi tha pasi që drejtori i Kulturës nuk qenka prezent në takim, le të mbetet për seancë të Kuvendit t’i propozoj disa pika që vijnë prej Drejtorisë së Kulturës.

Halim Halimi, kryesues, tha se pika e cila është e obligueshme, e që ka të bëjë me komplikime financiare, patjetër duhet kaluar përmes Komitet për Politik dhe Financa, por nëse është diçka që nuk ka komplikime financiare dhe janë 2-3 faqe, e propozon, por jo të propozohet p.sh. ndonjë rregullore me 100 faqe dhe aty për aty me u futur në rend dite pa u përgatitur.

Agim Gashi u shpreh i pajtimit që të shkojnë këto pika sipas rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015;

Halim Halimi, kryesues, tha se raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015, e kemi shqyrtuar në Komitet dhe jemi pajtuar që të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Agim Gashi u pajtua që raporti i Auditorit të Përgjithshëm të shqyrtohet në Kuvend. Ky raport i ka dy blloqe çështjesh: e para, se rekomandimet e vitit paraprak nuk janë zbatuar nga kryetari, nga 21 sosh, vetëm një është realizuar.

Ne kemi disa vërejtje të natyrave të ndryshme, siç është shkelja e procedurave të prokurimit, keq menaxhim i subvencioneve etj., të cilat do t'i trajtojmë në Kuvend në emër të GP-së.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Shqyrtimi i raportit vjetor buxhetor për vitin 2016.

Halim Halimi, kryesues, shprehu keqardhje për mos praninë e ekzekutivit (përfaqësuesit) që do të duhej të na informonin lidhur me raportin vjetor buxhetor për vitin 2016.

Agim Gashi tha se raporti vjetor buxhetor për vitin 2016 ka mjaft mangësi. Përveç pjesës së shfrytëzimit të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimit të tyre, raportit i mungon pjesa e bashkëpunimit me ndërmarrjet komunale. Gjatë punës në vitin 2016, janë përfituar fare pak donacione, vërehet tejkalimi i shpenzimeve jashtë planifikimit pa kaluar përmes buxhetit, janë zhvilluar procedurat pa vendim të Kuvendit, ku mbi 1.200.000 € janë jashtë planifikimit etj.

Lirak Çelaj bëri të ditur se komentet që kanë do t'i paraqesin në Kuvend.

Mirlinda Sopi u shpreh se po të ishte i pranishëm ekzekutivi, do t'i kisha kërkuar disa sqarime për disa pika, mirëpo në faqen e parë më pëlqeu që të hyrat vetjake ishin rritur në krahasim me ato të vitit të kaluar, si dhe taksat të shëndetësisë, ndërsa dilemat që i kam lidhur me raportin do t'i paraqes në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah shqyrtimi i raportit vjetor buxhetor për vitin 2016 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL "Hortikultura" SHA dhe NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë.

Halim Halimi, kryesues, tha se këtë pikë e kemi pasur edhe më herët në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe mbetet që në Kuvend të bëhen propozimet.

Mirlinda Sopi kërkoi të dijë se a e përcakton ligji që ajo parti që e ka pasur përfaqësuesin e vet më herët në atë ndërmarrje, ta dërgojë me automatizëm përfaqësuesin e vet, pra në aspektin ligjor a ka të drejt PDK-ja dhe LDK-ja me bërë këtë nëse nuk i ka votat në Kuvend.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se mund të shkojë ai i cili fiton shumicën e votave, pra mundet me shkuar edhe i partive të tjera.

Mirlinda Sopi tha se do të propozojmë edhe ne si parti, sepse kemi të drejtë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL "Hortikultura" SHA, dhe NPK "Trafiku Urban" SHA, Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

Halim Halimi, kryesues, dha sqarime të nevojshme, duke cekur se në seancën e fundit të Kuvendit është formuar një komision për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2016, dhe kemi pritur ligjshmërinë nga MAPL-ja, e që është vlerësuar pozitivisht. Ky komisioni është takuar dy herë lidhur me planin e punës. Ne e kemi pasur edhe më herët planin e punës, por nuk kemi mundur me e realizuar për shkak të problemeve që i kemi pasur. Tash e tutje jam i obliguar që çdo muaj të futen pikat e rendit të ditës sipas planit të punës së Kuvendit, siç janë në rend dite, e pastaj t'ia dërgoj ekzekutivit që edhe ata t'i fusin pikat tjera të rendit të ditës.

Agim Gashi theksoi se plani i punës është dokumente orientues, që na orienton teknikisht.

Laura Zherka tha se problemi qëndron në atë se pikat po na përsëriten nga seanca në seancë.

Agim Salihu dha sqarime shtesë lidhur me planin e punës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa morën vendim që t'i drejtohet me propozim ekzekutivit, që më 21.02.2017 të mbahet mbledhja e rregullt e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:50.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.